



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
SPITALI RAJONAL “MEMORIAL” FIER  
NJËSIA E PROKURIMIT



Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Fier, më 07.06.2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës -Sherbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Qiramarrje automjetesh”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Kodet CPV: **60170000-0**

**VLERA E FONDIT LIMIT: Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: 3,799,000 Lekë pa TVSH (tre milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntëmijë) lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Spitalit Rajonal “Memorial” Fier” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 .;*

*b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Kriteri Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

---

### **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**Kriteri 2.2.1** Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë **3 (tre) viteve** të fundit (**2020, 2021, 2022**), ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e ulët se 1 519 000 lekë lekë** (pra kjo vlerë e xhiros minimale vjetore nuk tejkalon 40% të vlerës së parashikuar të kësaj kontrate).

**Argumentimi per Kriterin 2.2.1:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa ”C”, për procedurat me objekt shërbime me fond limit nen kufirin e ulet monetar, siç është rasti i kësaj procedure, maksimumi i xhiros vjetore te kerkuar nuk duhet te tejkaloje 40% të vlerës së parashikuar të kësaj kontrate.

---

### **Kapaciteti teknik:**

**Kriteri 2.3.1** Dëshmi nga operatori ekonomik për shërbime të mëparshme të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës , në një vlerë jo më të ulët se **759 000 lekë** (pra kjo vlerë totale e kontratave të mëparshme të realizuara gjatë tre viteve të fundit , nuk tejkalon 20% të vlerës së parashikuar të kësaj kontrate).

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik per permbushjen me sukses të kontratës, ku e shënohet vlera, afati i përfundimit te kontrates ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara .
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

### **Specifikime teknike**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuar, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

Ky shërbim përfshin qeradhënien nga ana e Operatorëve ekonomik të interesuar të 3 (tre) automjeteve nga të cilat :

- 2 (dy) automjete me nr.vendesh 4+1
- 1 (një) automjet me nr.vendesh 17+1

për transportin e personelit/të punësuarve me shtetësi turke maksimumi 40 (dyzet) punonjës në muaj, në zbatim të Vendimit e Këshillit të Ministrave të Shqipërisë 58, datë 26.1.2022 “Për miratimin e Protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier, gjatë fazës kalimtare” , sipas të cilit një prej detyrimeve të palës shqiptare është të mbulojë shpenzimet e brendshme të transportit të personelit që do të emërohen në këtë projekt nga pala turke.

### ❖ AUTOVETURË FUORISTRADË:

#### Specifikimet teknike si më poshtë:

- |                                  |  |
|----------------------------------|--|
| ◦ Viti i prodhimit:              | jo më para se viti 2022 (2022 e sipër) |
| ◦ Motori Turbo Diezel            | 1.6                                    |
| ◦ Lënda djegëse                  | Naftë                                  |
| ◦ Fuqia Motorike                 | min 100 kw/136 kf                      |
| ◦ Numri i cilindrave             | min 4                                  |
| ◦ Konsumi i kombinuar per 100 km | Max 7 litra / 100 km                   |

#### Transmisioni:

- |                               |                  |
|-------------------------------|------------------|
| ◦ Kutia e shpejtësisë (Kamio) | Automatike       |
| ◦ Shpejtësia maksimale        | Min 180 km / orë |
| ◦ Tërheqja                    | 2x4              |

#### Përmasat e autoveturës:

- |                     |                           |
|---------------------|---------------------------|
| ◦ Gjatësia          | Min 4400 mm– Max 4500 mm  |
| ◦ Lartësia          | Min 1600 mm – Max 1700 mm |
| ◦ Gjerësia          | Min 1800 mm– Max 1900 mm  |
| ◦ Distanca aksiale  | Min 2600 mm – Max 2700 mm |
| ◦ Lartësia nga toka | Min 180 mm                |

#### Gabina:

- |                   |         |
|-------------------|---------|
| ◦ Numri i dyerve  | 4       |
| ◦ Numri i vendeve | Min 4+1 |

#### Aksesorë shtesë:

- Timon hidraulik , në krahun e majtë
- Frenat me system ABS

- Sistem ASR
- Airbag për shoferin dhe pasagjerin
- Xhamat me nuancë
- Xhamat anësore : Me komandim elektrik
- Ajer i kondicionuar /Clima
- Sistem elektrik 12V si dhe te jëtë konform normave të CE
- Mbyllje e centralizuar e dyerve , komandim në distancë
- Radio me touch
- Timon multifunksional
- Cruis Control
- Disqe alumini min 18
- Drita e para anësore LED
- Kamera
- Sensor parkimi para dhe mbrapa
- Xhamat e errët mbrapa
- Ndezje me gisht
- Ngjyra e negociueshme

#### ❖ AUTOVETURË 4+1:

##### Specifikimet teknike si më poshtë:

- |                                  |                      |
|----------------------------------|----------------------|
| ◦ Motori Turbo Diezel            | 1.6                  |
| ◦ Lënda djegëse                  | Naftë                |
| ◦ Fuqia Motorike                 | min 100 kw/136 kf    |
| ◦ Numri i cilindrave             | min 4                |
| ◦ Konsumi i kombinuar per 100 km | Max 5 litra / 100 km |

##### Transmisioni:

- |                               |                     |
|-------------------------------|---------------------|
| ◦ Kutia e shpejtësisë (Kamio) | manuale /automatike |
| ◦ Tërheqja                    | 2x4                 |

### Përmasat e autoveturës:

- Gjatësia Min 4300 mm– Max 4400 mm
- Lartësia Min 1400 mm – Max 1500 mm
- Gjerësia Min 1700 mm– Max 1800 mm
- Distanca aksiale Min 2500 mm – Max 2600 mm

### Gabina:

- Numri i dyerve 4
- Numri i vendeve Min 4+1

### Aksesorë shtesë:

- Timon hidraulik , në krahun e majtë
- Frenat me system ABS
- Sistem ASR, ESP
- Airbag për shoferin dhe pasagjerin
- Xhamat me nuancë
- Xhamat anësore : Me komandim elektrik
- Ajer i kondicionuar /Clima
- Sistem elektrik 12V si dhe te jëtë konform normave të CE
- Mbyllje e centralizuar e dyerve , komandim në distancë
- Radio
- Ngjyra e negociueshme

### **❖ AUTOBUS/FURGON 17+1:**

### Specifikimet teknike si më poshtë:

- Motori Turbo Diesel Min: 2.0
- Lënda djegëse Diesel
- Fuqia Motorike min 95kw
- Numri i cilindrave min 4
- Konsumi i kombinuar per 100 km Max 9 litra / 100 km

### Transmisioni:

- Kutia e shpejtësisë (Kamio) Automatike /Manuale
- Tërheqja 2x4

Përmasat e autoveturës:

- Gjatësia Min 5900 mm
- Lartësia Min 2500 mm
- Gjerësia Min 2000 mm
- Distanca aksiale Min 4000 m

Gabina:

- Numri i dyerve 4
- Numri i vendeve Min 15+1

Aksesorë shtesë:

- Timon hidraulik , në krahun e majtë
- Frenat me system ABS
- Sistem ASR, ESP
- Airbag për shoferin dhe pasagjerin
- Xhamat me nuancë
- Xhamat anësore : Me komandim elektrik
- Ajer i kondicionuar /Clima
- Sistem elektrik 12V si dhe te jëtë konform normave të CE
- Mbyllje e centralizuar e dyerve , komandim në distancë
- Radio
- Ngjyra e negociueshme

Operatori ekonomik merr persiper qeradhenien e 3 (tre) automjeteve së bashku me detyrimet:

- Zëvendësim i gomave cdo 40,000 (dyzetë mijë) km përvec rasteve kur ato janë dëmtuara nga përdoruesi pa plotësuar km e sipërpërmendur.
- Shërbimet periodike ( ndërrim vaji, filtrash, frenash etj) si dhe ato të nevojshme të llogaritura për një distancë të përshkuar jo më shumë se 25,000 km/vit.
- Zëvendësim brenda 3 ditëve të automjetit/automjeteve me një kategori të ngjashme mjete në rast defekti.

Operatori ekonomik me lëvrimin e mallit duhet të dorëzojë dokumentacionin sa më poshtë:

1. Operatori ekonomik duhet të ketë të shlyera të gjitha detyrimet në lidhje me institucionet përkatëse për automjetet në fjalë: Taksa rrugore/qarkullimi të vitit përkatës. Për këtë duhet të paraqesë dokumentat origjinale ose kopje të noterizuara të këtyre dokumentave.

2. Operatori ekonomik duhet të ketë të treja mjetet që do t'i ofrojë me qera Autoritetit Kontraktor te pajisura me siguracion të detyrueshëm TPL si dhe siguracion të plotë Kasko (mbulim për vjedhje/zjarr/dëme) për të gjithë periudhën e plotë të qirasë. Për këtë duhet të paraqesë siguracionet origjinale ose kopje të noterizuara të siguracioneve.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Dokumentat e tenderit janë hartuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Referuar pikës 5 të nenit 82 të Ligjit 162 date 23.12.2020 "Për prokurimin publik" operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike si dhe dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna, jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar.

## **NJËSIA E PROKURIMIT:**